

MI-620 MONOBLOCK

Hidroizolues elastomerik, një komponentësh, i modifikuar me polimer, për mbrojtje nga uji me bazë cemento, i përforcuar me Fibre Strength Tech.



PAKETIMI
25kg



**RAPORTI I
PËRZIERJES**
6.9-7.9 L/25kg



KONSUMI
1.7 kg/m²

Përshkrimi

MI-620 MONOBLOCK është një hidroizolues elastomerik, një komponentësh, i modifikuar me polimer, për mbrojtje nga uji me bazë cemento, i përforcuar me Fibre Strength Tech. Ka rezistencë të mirë ndaj kripërave për aplikime brenda dhe jashtë dhe punueshmëri të mirë.

Fushat e Përdorimit

- Përdoret për mbrojtje nga uji për banja, dushe, ballkone para vendosjes së pllakave të qeramikës.
- Përdoret për mbrojtje nga uji për puset e betonit të ujit të pijshëm.

Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqja që do të mbulohet duhet të jetë pa pluhur, yndyrë, bojë, etj. Rekomandohet ta lagni para aplikimit. Përdorni MP-809 ACRYPRIME për të rritur ngjitjen e MI-620 MONOBLOCK me sipërfaqen.

Aplikimi

MI-620 MONOBLOCK shtohet ngadalë në ujë duke e përzier vazhdimisht deri sa të formohet një masë homogjene. Rekomandohet përzierës me shpejtësi të ulët për përzierjen. Aplikohet një shtresë e hollë e MI-620 MONOBLOCK me furçë ose rul, pastaj pas 5-6 orësh aplikohet një shtresë e dytë për të arritur një trashësi finale prej rreth 2-3 mm.

Vendosni një rrjetë 4.5 x 4 mm në shtresën e parë të MI-620 MONOBLOCK kur punoni rreth nyjeve të zgjerimit, nyjeve mes sipërfaqeve horizontale dhe vertikale, vendeve me ndarëse të vogla ose vendeve që janë të ekspozuara ndaj presionit. Pasi të vendoset rrjeta, aplikohet një shtresë e dytë e MI-620 MONOBLOCK kur e para të jetë tharë (pas 5-6 orësh).

Konsumi

Konsumon 1.7 kg/m², në varësi të sipërfaqes.

Karakteristika



Të dhëna teknike (NE +23 °C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Magaznimi	12 muaj kur ruhet në paketimin origjinal të mbyllur në një vend të thatë.
Raporti i perzierjes	6,9-7,9 Litra uje /25 kg (me furce) 4-5 Litra uje /25kg me spatul)
Konsumi	0.85-1kg/m ² /mm
Punueshmeria	2 ore
Fortësia fillestare e lidhjes në tërheqje dhe pas kontaktit me ujin, maturimit termik dhe cikleve të ngrirjes-shkrirjes (EN 14891)	≥ 1 N/mm ²
Forca e ngjitjes në tërheqje (EN 1542)	≥ 2 N/mm ²
Rezistencë ndaj kripës së rrugës për ngrirje dhe shkrirje (EN 13687-3)	≥ 1 N/mm ²
Depërtimi i ujit nën presion (EN 14981)	7 bar (positive)
Substancat e rrezikshme	Shiko SDS

MATIS Construction Chemicals

Tiranë, Albania

info@matís-eu.com

www.matis-eu.com

T: +355 69 20 94 570